



**AUTORITETI I MBIKËQYRJES
FINANCIARE**



**DREJTORIA E
PERGJITHSHME
E TATIMEVE**

**MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E TATIMEVE**

Nr. 2544 Prot.
11.09.2017

Nr. 2153 Prot.
11.9.2017

MARRËVESHJE

NDËRMJET

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

DHE

AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

MBI

**“INSPEKTIMET E PËRBASHKËTA NË SHOQËRITË E SIGURIMEVE
DHE SUBJEKTET E TJERA NË MBIKËQYRJE TË AMF-SË DHE SHKËMBIMIN E
INFORMACIONIT”**

TIRANË, 2017

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

DHE

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Me qëllim zbatimin e Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në kuadër të ushtrimit të kompetencave të ngarkuara nga ligji, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve që këtu e në vijim do të përmenden shkurt DPT dhe AMF,

BIEN DAKORD:

Të lidhin këtë marrëveshje si më poshtë:

Neni 1

QËLLIMI I MARRËVESHJES

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është kryerja e inspektimeve të përbashkëta midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sipas afateve dhe rregullave proceduriale në fuqi për kontrollin, si dhe shkëmbimin e informacioneve në funksion të këtyre inspektimeve.

Neni 2

PARIME TË PËRGJITHSHME TË INSPEKTIMEVE

Inspektimet e përbashkëta midis AMF-së dhe DPT-së udhëhiqen nga parimet e përgjithshme të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, në legjislacionin fiskal dhe në legjislacionin për mbikëqyrjen financiare të shoqërive të sigurimit e subjekteve të tjera nën mbikëqyrje të AMF-së.

Neni 3

BAZA LIGJORE

Kjo marrëveshje është e bazuar në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH.”, i ndryshuar, nenin 24, të Ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre.

Neni 4

OBJEKTI I INSPEKTIMEVE

Objekt i inspektimeve të përbashkëta midis AMF-së dhe DPT-së, janë:

1. Zbatimi i dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi, që rregullojnë veprimtarinë e tregjeve financiare që mbikëqyren, parandalimi dhe identifikimi i shkeljeve;
2. Zbatimi i dispozitave të legjislacionit tatimor në fuqi;
3. Ligjshmëria e kryerjes së shpenzimeve nga shoqëritë e sigurimeve dhe mbajtja në rregull e dokumentacionit kontabël dhe atij tatimor;
4. Emetimi, anulimi, asgjësimi i policave të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit;
5. Ligjshmëria e veprimtarisë së subjekteve nën mbikëqyrjen e AMF-së.

Neni 5

BAZA PËR FILLIMIN E INSPEKTIMIT

1. Inspektimi nis mbi bazën e kërkesës së Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të AMF-së dhe/ose të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.
2. Grupet e inspektimit të përbashkët përbëhen nga përfaqësues të DPT-së dhe përfaqësues të AMF-së.
3. Secila palë njofton palën tjetër, si rregull një muaj më parë, me qëllim që të bashkërendojnë programet dhe planet e kontrollit, si dhe procedurat përkatëse rast pas rasti.
4. Në rast të pamundësisë objektive për t'u angazhuar në inspektimet e përbashkëta sipas kërkesës, pala respektive njofton kërkuesin brenda 5 ditësh nga marrja e kërkesës.

Neni 6

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SUBJEKTEVE TË INSPEKTUARA

1. Të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të inspektuara janë ato që parashikohen në Ligjin nr.52, datë 22.05.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në R.SH.", i ndryshuar dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tyre.
2. Subjekti i inspektuar është i detyruar:
 - Të sigurojë kushte normale për inspektim;

- Të vendosë në dispozicion në ambientet e punës, dokumentacionin që kërkohet;
- T'u përgjigjet pyetjeve të inspektorëve;
- Të caktojë personat e kontaktit me grupin e inspektimit për të ndihmuar në kryerjen e inspektimit;
- Të vendosë në dispozicion çdo të dhënë tjetër që kërkohet, për të përcaktuar faktet dhe rrethanat, në lidhje me çështjet për të cilat kryhet inspektimi.

NENI 7

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E GRUPIT TË INSPEKTIMIT

1. Grupi i përbashkët i inspektimit, para fillimit të procedurave të inspektimit është i detyruar të paraqesë urdhrin e inspektimit.
2. Inspektimet/kontrollet do të kryen sipas procedurave të parashikuara shprehimisht në dispozitat materiale në fuqi.
3. Në përfundim të inspektimeve, administrata tatimore do të marrë masat për përlogaritjen e detyrimeve tatimore për subjektet e kontrolluar sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Në përfundim të procedurës së kontrollit dhe nxjerrjes së aktit nga konstatimi tatimor përkatës, aktet do të kalojnë në AMF (Departamenti i Mbikëqyrjes Financiare) me shkresë përcjellëse për veprime të mëtejshme.

Neni 8

NJËSITË ZBATUESE

Grupet e inspektimit/kontrollit për zbatimin e kësaj marrëveshje do të përcaktohen rast pas rasti dhe me pëlqimin e të dy palëve.

Neni 9

PËRDORIMI I INFORMACIONIT DHE KONFIDENCIALITETI

1. Çdo informacion i dhënë ose i marrë gjatë procesit të inspektimit duhet të trajtohet si konfidencial.
2. Çdo institucion duhet të ruajë informacionin që merr nga institucioni tjetër në përputhje me normën e konfidencialitetit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.
3. Palët nuk kanë të drejtë të vënë në dispozicion të ndonjë pale të tretë informacionin që kanë marrë sipas kësaj Marrëveshje, pa marrë më parë miratimin paraprak të institucionit që jep informacionin.

Neni 10
SHKËMBIMI I INFORMACIONIT ME KËRKESË

1. AMF dhe DPT, përveç informacionit që mund të marrin gjatë procesit të inspektimit të përbashkët, shkëmbejnë gjithashtu informacion midis tyre pas kërkesës me shkrim të paraqitur nga secila palë në funksion dhe përkatësisht për qëllime të mbikëqyrjes së tregjeve financiare dhe për qëllime të administrimit tatimor.
2. Çdo institucion duhet të ruajë informacionin që merr nga institucioni tjetër në përputhje me normën e konfidencialitetit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.

Neni 11
SHQYRTIMI I MARRËVESHJES

Institucionet nënshkruese rishikojnë vazhdimisht zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe e konsultojnë atë me synimin e përmirësimit dhe të zgjidhjes së problemeve të ndryshme që mund të dalin.

Neni 12
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Ngarkohen AMF dhe DPT me strukturat e tyre përbërëse për zbatimin e detyrave të parashikuara në këtë Marrëveshje.
2. Çdo rregullim ose ndryshim sipas nenit 11, në këtë Marrëveshje, bëhet vetëm nëpërmjet pëlqimit reciprok të palëve.
3. Palët duhet t'i përgjigjen propozimeve reciproke për rregullime ose ndryshime, jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së këtij propozimi.
4. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.
5. Marrëveshja mund të përfundojë me njoftimin me shkrim të secilës palë, një muaj pas këtij njoftimi.
6. Kjo marrëveshje hartohet në katër kopje dhe secila nga palët mban dy kopje në origjinal.

Neni 13
HYRJA NË FUQI


1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.
2. Kjo Marrëveshje do të jetë në fuqi për një periudhë kohe të pacaktuar.

Nënshkruar sot, më datë 11 / 08 /2017, në Tiranë.

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E TATIMEVE**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Vasilika VJERO



**AUTORITETI I MBIKËQYRJES
FINANCIARE**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM
EKZEKUTIV**

Ervin KOÇI

